



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 52

Qershor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.342, datë 12.4.2006	Për përcaktimin e detyrimit të ANTA, sha-së, për kryerjen e pagesave, që rrjedhin nga anëtarësimi në Eurocontrol	3
Vendim i KM nr.348, datë 7.6.2006	Për informatizimin e regjistrit tregtar.....	3
Vendim i KM nr.373, datë 14.6.2006	Për caktimin e anëtarit të ekipit përzgjedhës për zgjedhjen e kandidatëve, anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.....	4
Vendim i KM nr.375, datë 14.6.2006	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të bashkisë së Peqinit	4
Vendim i KM nr.379, datë 14.6.2006	Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Ali Buletini	5
Vendim i KM nr.380, datë 14.6.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zonjës Margarita Milkani (Kristidhi)	5
Vendim i KM nr.381, datë 14.6.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Piro Milkani	5
Vendim i KM nr.406, datë 21.6.2006	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.8, datë 5.1.2002 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore”, të ndryshuar	6
Vendim i KM nr.431, datë 28.6.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.762, datë 13.11.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Bankës së Shqipërisë”	6

Vendim i KM nr.433, datë 28.6.2006	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës së Golemit	7
Vendim i KM nr.436, datë 28.6.2006	Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë së kandidaturave alternative për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës	7
Vendim i KM nr.439, datë 28.6.2006	Për marrjen e masave për zbatimin e studimit të reformës së kërkimit shkencor, pjesë e rrjetit të instituteve të ministrive të linjës	8
Vendim i KM nr.440, datë 28.6.2006	Për emërim në detyrë	16
Vendim i KM nr.449, datë 6.7.2006	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave në grupin mbikëqyrës	16
Vendim i KM nr.458, datë 8.7.2006	Për “Shpallje ditë zije kombëtare”	17
Vendim i KM nr.460, datë 10.7.2006	Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, për shërbim konsulence, për përgatitjen e termave të prokurimit/konkurritimit ndërkombëtar, vlerësimin, përzgjedhjen dhe negociimin e kontratës për ndërtimin e seksionit qendror të autostradës Durrës- Kukës-Morinë	17
Vendim i KM nr.462, datë 5.7.2006	Për dhënie ndihme financiare znj.Lindita Çala, për strehimin e familjes së saj, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave	20
Vendim i KM nr.475, datë 12.7.2006	Për dhënie e emrit “Arbnori” Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës	20
Vendim i KM nr.476, datë 12.7.2006	Për mbulimin e detyrimeve të prapambetura, për shpenzimet e transportit të mësuesve dhe të nxënësve, të trashëguara nga viti 2003	21
Vendim i KM nr.481, datë 14.6.2006	Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën e prokurimit “Tender i hapur ndërkombëtar, për ndërtimin, me ritme të përshpejtuara”, të segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash, të autostradës Durrës-Kukës-Morinë	21
Vendim i KM nr.491, datë 31.5.2006	Për lirimin dhe emërimin e një anëtari të Këshillit të Statistikave.	22
Vendim i KM nr.499, datë 19.7.2006	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Divjakë, të qarkut të Fierit	23
Vendim i KM nr.521, datë 26.7.2006	Për lirim dhe emërim në detyrë	23

Vendim i KM nr.522, datë 26.7.2006	Për transferimin e sipërfaqes 91 m ² , komponente e pronës nr.1095 “Dega e mobilizim-rekrutimit”, Kuçovë, nga Ministria e Mbrojtjes në pronësi të bashkisë së qytetit Kuçovë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave	24
Vendim i KM nr.527, datë 2.8.2006	Për emërimin në detyrë të tre anëtarëve të Entit Rregullator të Ujit (ERRU)	24
Vendim i KM nr.533, datë 4.8.2006	Për pajisjen me mjedise të Partisë Demokristiane	25
Vendim i KM nr.534, datë 4.8.2006	Për pajisjen me mjedise të Partisë Republikane	26
Vendim i KM nr.535, datë 4.8.2006	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të Institutit të Studimit të Tokave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave	28
Vendim i KM nr.536, datë 4.8.2006	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të cilat i kalojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dega tatim-taksave, Tiranë	29
Vendim i KM nr.540, datë 10.8.2006	Për organizimin e ceremonisë, në nderim të viktimave të aksidentit ajror	29
Vendim i KM nr.553, datë 16.8.2006	Për njehsimin e funksioneve organike sipas gradave në strukturën e Gardës së Republikës së Shqipërisë	30
Vendim i KM nr.569, datë 23.8.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.267, datë 10.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e ekspertëve financiarë në shoqëritë huamarrëse, në administrim”	30
Vendim i KM nr.570, datë 23.8.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.335, datë 20.6.2000 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar .	31
Vendim i KM nr.572, datë 24.8.2006	Për emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	31
Vendim i KM nr.573, datë 23.8.2006	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Hysgjokaj të qarkut të Fierit.....	32
Vendim i KM nr.584, datë 23.6.2006	Për ngritjen e monumentit të heroit të demokracisë, Azem Hajdari, në qytetin e Tiranës	33
Vendim i KM nr.585, datë 23.8.2006	Për hapjen e konsullatës së përgjithshme të Republikës së shqipërisë në Nju-Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës	35

Vendim i KM nr.586, datë 23.8.2006	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit “Programi Iliria”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, për futjen e gjuhës italiane në sistemin parauniversitar shqiptar	35
Vendim i KM nr.588, datë 30.8.2006	Për dërgimin në paris, francë, të 5 ikonave, objekte të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta, për ekspozim	37
Vendim i KM nr.592, datë 31.8.2006	Për një shtesë në vendimin nr.56, datë 28.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit të barnave”	38
Vendim i KM nr.599, datë 31.8.2006	Për përbërjen e komisionit të kualifikimit shkencor	38

VENDIM
Nr.342, datë 12.4.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E DETYRIMIT TË ANTA SHA-SË, PËR KRYERJEN E PAGESAVE,
QË RRJEDHIN NGA ANËTARËSIMI NË EUROCONTROL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8821, datë 15.10.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare të Eurocontrol-it”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. ANTA sh.a., nga të ardhurat e shërbimit të mbikalimit ajror, duhet të derdhë, çdo vit, në Agjencinë e Eurocontrol-it, kontributin e anëtarësimit, në emër të shtetit shqiptar.

2. ANTA sh.a., nga të ardhurat e shërbimit të mbikalimit ajror, duhet të derdhë, çdo vit, në Buxhetin e Shtetit, koston e DPAC-së për veprimtarinë e mbikalimit, e cila është përfshirë në çmimin për njësi, që arkëtohet nga Eurocontrol-i. Kostoja e DPAC-së për veprimtarinë e mbikalimit të përcaktohet sipas rregullave në marrëveshjet me Eurocontrolin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.348, datë 7.6.2006

PËR INFORMATIZIMIN E REGJISTRIT TREGTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për realizimin e informatizimit të regjistrit tregtar, Instituti i Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar (INIMA) realizon:

a) në mjediset e veta, me një grup juristësh, përpunimin e dosjeve të regjistrit tregtar, që ndodhen në gjykatën e Tiranës, duke nxjerrë si produkt një ekstrakt të standardizuar, për t’u regjistruar në kompjuter;

b) programin që do të funksionojë në rrjet për regjistrimin e ekstrakteve në kompjuter, si dhe për nxjerrjen e tyre në shtyp, sa herë që të jetë e nevojshme;

c) regjistrimin në kompjuter të këtyre të dhënave, për rreth 50 mijë shoqëri tregtare të regjistruara, me një ekip operatorësh, që do të punojnë në mjediset e INIMA-s.

2. Të gjitha të dhënat do të regjistrohen në dy servera, të cilat, në përfundim të këtij projekti, të kalojnë pronë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

3. Për realizimin e këtij regjistri të punësohen, për 4 muaj, punonjës me kontratë pune të përkohshme, nga të cilët:

- juristë 40 punonjës;
- operatorë 40 punonjës.

4. Buxheti për realizimin e “Informatizimit të regjistrit tregtar”, të jetë 11 054 744 (njëmbëdhjetë milionë e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e dyzet e katër) lekë dhe efektet financiare të përballohen nga fondi i Ministrisë së Financave.

5. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, që, në bashkëpunim me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, të organizojnë punën për drejtimin metodologjik, kualifikimin e juristëve, për nxjerrjen e ekstraktit, si dhe për dorëzimin e dosjeve në INIMA.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për ndjekjen dhe realizimin e këtij projekti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.373, datë 14.6.2006

PËR CAKTIMIN E ANËTARIT TË EKIPIT PËRZGJEDHËS PËR ZGJEDHJEN E KANDIDATËVE, ANËTARË TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Zonja Enkelejda Patozi, caktohet anëtare e ekipit përzgjedhës për zgjedhjen e kandidatëve, anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.375, datë 14.6.2006

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË BASHKISË SË PEQINIT

Në mbështetje të neneve 100, pika 2 e 115 të Kushtetutës, dhe të shkronjës “a” të nenit 42 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Skënder Hasa shkarkohet nga detyra e kryetarit të bashkisë së Peqinit, për shkelje të rënda ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.379, datë 14.6.2006

PËR DHËNIE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZOTIT ALI BULETINI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Ali Buletini, në masën e dyfishit të pensionit maksimal, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.380, datë 14.6.2006

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZONJËS MARGARITA MILKANI (KRISTIDHI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zonjës Margarita Milkani (Kristidhi), në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.381, datë 14.6.2006

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZOTIT PIRO MILKANI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Piro Milkani, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.406, datë 21.6.2006

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.8, DATË 5.1.2002, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKUT TË QENIEVE NJERËZORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.8, datë 5.1.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 shtohet emërtimi “Zëvendësministri i Shëndetësisë, anëtar.”

2. Pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Me propozimin e zëvendësministrit të Brendshëm për çështjet e luftës kundër trafikut, Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj, analizon raportet për punën e kryer nga çdo institucion shtetëror dhe institucionet e tjera për zbatimin e detyrimeve, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, si dhe rekomandon zgjidhjet e mundshme për problemet e ndryshme.”.

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Njësia antitrafik drejtohet nga zëvendësministri i Brendshëm për çështjet e luftës kundër trafikut dhe, në bashkëpunim me personat përgjegjës për bashkërendimin e punës dhe të të dhënave, përfaqësues të institucioneve të përfshira në strategji, përgatit materialet referuese për mbledhje.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.431, datë 28.6.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.762, DATË 13.11.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI BANKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.762, datë 13.11.2003 të Këshillit të Ministrave, në listën që i bashkëlidhet, përmasat e disa pronave, në inventarin e miratuar për Bankën e Shqipërisë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.433, datë 28.6.2006

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË GOLEMIT

Në mbështetje të neneve 100, pika 2 e 115 të Kushtetutës, dhe të shkronjës “a” të nenit 42 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Demir Lika shkarkohet nga detyra e kryetarit të komunës së Golemit, për shkelje të rënda ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.436, datë 28.6.2006

**PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË SË
KANDIDATURAVE ALTERNATIVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 21 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë së kandidaturave alternative për dy anëtarë të komisionit të konkurrencës, si më poshtë vijon:

- Për anëtarin e parë:

Znj. Lindita Lati;

Znj. Flora Musta.

- Për anëtarin e dytë:

Znj. Servete Gruda;

Z. Halit Xhafa.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.439, datë 28.6.2006

**PËR MARRJEN E MASAVE PËR ZBATIMIN E STUDIMIT TË REFORMËS SË
KËRKIMIT SHKENCOR, PJESË E RRJETIT TË INSTITUTEVE TË MINISTRIVE TË
LINJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të marrin masat e nevojshme për zbatimin e studimit të reformës së kërkimit shkencor, sipas tabelave të aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministrinë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi të paraqesin për miratim, në Këshillin e Ministrave, paketën e plotë të hollësishme për riorganizimin institucional të institucioneve të kërkimit shkencor në varësi të tyre, si më poshtë vijon:

- për projektligjet afati i fundit i paraqitjes së tyre të jetë data 22 korrik 2006;
- për projektvendimet afati i fundit i paraqitjes së tyre të jetë data 7 korrik 2006.

3. Ngarkohen ministrinë e përmendura për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REKOMANDIME PËR RIORGANIZIMIN INSTITUCIONAL TË INSTITUTEVE TE MINISTRIVE TE LINJES

INSTITUTI	PROPOZIMET KONKRETE PËR REFORMIMIN E INSTITUCIONIT KËRKIMOR	PROPOZIMET KONKRETE PËR INSTITUCIONIN E RI OSE ATË PRITËS
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKES (METE) 1. SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR (ShGjSh), TIRANË	- Propozohet që të reformohet tërësisht për të kryer vetëm funksiione shërbimi, këshillimi dhe transferimi të teknologjisë në fushat e gjeologjisë dhe pasurive natyrore sipërfaqësore dhe nëntokësore të territorit të Shqipërisë. Njësitë që deri tani kanë kryer kërkim shkëputen nga ky institucion dhe kalojnë pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. - Ky shërbim do të përfaqësohet në qendër me një Drejtori të Përgjithshme. - Shërbimi do të de-koncentrohet duke u organizuar në Divizione Rajonale të cilat do të varen edhe nga prefekturat. - Krijohet Qendra Kërkimore e Gjeoshkencave (QKGJ) pranë Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT). Instituti i Kërkimeve Gjeologjike, Qendra Gjeofizike dhe një pjesë e laboratorëve të Gjeoinformatizimit dhe Publikimeve integrohen në QKGJ pranë UPT.	Qendra Kërkimore e Gjeoshkencave (QKGJ) ngrihet pranë UPT. Kjo Qender do të perbehet nga departamentet e Gjeologjisë, Sizmikes, Hidrologjisë dhe Meteorologjisë.

INSTITUTI	PROPOZIMET KONKRETE PËR REFORMIMIN E INSTITUCIONIT KËRKIMOR	PROPOZIMET KONKRETE PËR INSTITUCIONIN E RI OSE ATË PRITËS
<u>METE</u> 2. QENDRA KOMBËTARE SHKENCORE E HIDROKARBUREVE (QKSHH)- FIER	Sektorët që kryejnë kërkim shkencor kalojnë në QKGJ pranë UPT. Sektorët e tjerë kalojnë në Divizionet Rajonale të Shërbimit Gjeologjik pranë Prefekturave Fier, Berat dhe Vlorë. Dokumentacioni shkencor transferohet në Arkivin Shtetëror të Gjeologjisë në Tiranë.	Qendra Kërkimore e Gjeoshkencave (QKGJ) ngrihet pranë UPT.
<u>METE</u> 3. INSTITUTI I TEKNOLOGJISË SË NXJERRJES DHE PËRPUNIMIT TË MINERALEVE, TIRANË	Të riorganizohet si AGJENCIA SHTETËRORE E BURIMEVE MINERALE DHE ENERGJITIKE (ASHBME) pranë METE. Në këtë agjenci duhet të përfshihet edhe AGJENCIA KOMBËTARE E HIDROKARBUREVE. Bazuar në misionin e ri të kësaj Agjencie, laboratorët e këtij Instituti kalojnë në Qendren e Gjeoshkencave pranë UPT.	ASHBME të përbëhet nga 3 departamente: • Departamenti i Mineraleve • Departamenti i Hidrokarbureve • Departamenti Hidroteknik Misioni i kësaj Agjencie duhet të jetë mbikqyrja e aktivitetëve tekniko-ekonomike për burimet minerale, ato të hidrokarbureve (naftë dhe gaz) si dhe burimet hidroenergjitike (hidrocentrale).
<u>METE</u> 4. INST. I STUDIMEVE & PROJEKTIMEVE TË INDUST. LEHTË, TIRANË	Ristrukturohet dhe i bashkëngjitet Inspektoriatit Qendror Teknik.	
<u>METE</u> 5. INST. I MEKANIKES & DRURIT, TIRANË	Shkrihet si institut.	
<u>METE</u> 6. INST. I METALURGJISË, ELBASAN	Shkrihet si institut.	

INSTITUTI	PROPOZIMET KONKRETE PËR REFORMIMIN E INSTITUCIONIT KËRKIMOR	PROPOZIMET KONKRETE PËR INSTITUCIONIN E RI OSE ATË PRITËS
<u>MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE (MPPTT)</u> 7. INST. I NDERTIMIT, TIRANË	Bashkohet me Dept. e Ndërtimit të Fakultetit të Ndërtimit, të UPT.	
<u>MPPTT</u> 8. INST. I URBANISTIKES, TIRANË	Bashkohet me Dept. e Arkitekturës dhe Urbanistikës në Fak. e Ndërtimit, UPT.	
<u>MPPTT</u> 9. INST. I TRANSPORTIT, TIRANË	Mbetet në MPPTT si njësi shërbimi.	
<u>MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE & ADMINISTRIMIT TË UJRAVE (MMPAU)</u> 10. INSTITUTI I MJEDISIT, TIRANË	Krijohet <u>Agjencia e Mjedisit & Pyjeve</u> në varësi të MMPAU. Ajo përfshin Inst. E Mjedisit dhe atë të Pyjeve dhe Kullotave. Misioni i saj do të jetë mbështetje teknike dhe këshillim i ministrisë në fushën e mjedisit dhe pyjeve.	Kërkimi shkencor në fushën e mjedisit do të jetë misioni i Qendrës Kërkimore të Energjisë dhe Mjedisit (QKEM) , e cila do ngrihet pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.
<u>MMPAU</u> 11. INSTITUTI I KËRKIMIT TË PESHKIMIT, DURRËS	- <u>Instituti dhe stacioni i tij në Tapizë</u> bashkohen me Seksionin e Aqualkulturës të Dept. të Prodhimit Shtazor të Fakultetit të Bujqësisë, të UBT. Stacionet eksperimentale në Lin (Pogradec) dhe Zvezdë (Korçë) bëhen pjesë të Agjencive Rajonale të Mjedisit dhe kanë si mision ruajtjen e peshqve të rrezikuar.	Ky departament do të promovojë kërkimin shkencor në fushën e aqualkulturës dhe peshkimit si dhe formimin e studentëve dhe shkencëtarëve të rinj në këto fusha përmes moduleve në studimet Bachelor, kurseve të piota të Masterit si dhe doktoratave.
<u>MMPAU</u> 12. INSTITUTI I KËRKIMEVE PYJORE DHE KULLOTAVE, TIRANË	Instituti transformohet në një njësi shërbimi dhe këshillimi në përbërje të Agjencisë së Mjedisit & Pyjeve (shih më lart). Stacionet ekzistuese të këtij instituti kalojnë në varësi të drejtorive të shërbimit pyjor në rrethe.	

INSTITUTI	PROPOZIMET KONKRETE PËR REFORMIMIN E INSTITUCIONIT KËRKIMOR	PROPOZIMET KONKRETE PËR INSTITUCIONIN E RI OSE ATË PRITËS
<u>MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT (MBUMK)</u> 13. INSTITUTI KËRKIMOR TË BIMËVE TË ARAVE, FUSHË KRUJË	-Kthehet në Qendër Këshillimi dhe Transferimi të Teknologjisë e MBUMK, në Fushë Krujë . Bashkëpunon me UBT, mbi bazën e kontratës për praktikant e studentëve. -Stacioni i këtij instituti në Korçë bashkohet me Stacionin e bagëtive të lmta, aktualisht pjesë e Institutit të Zooteknisë, për të formuar Qendrën e Këshillimit dhe Transferimit të Teknologjisë e MBUMK, në Korçë. Këto qendra duhet të mbështeten me një buxhet shumë të kufizuar nga MBUMK dhe pjesën më të madhe të veprimtarisë duhet ta mbështesin në të ardhurat që thithin.	Qendrat e Këshillimit dhe Transferimit të Teknologjisë do të kenë si detyra kryesore: • Këshillimin dhe transferimin e teknologjive të reja në ferma; • Kualifikimin e vazhduar të specialistëve të bujqësisë dhe sektorit rural; • Kualifikimin praktik të fermerëve të rinj dhe studentëve të shkencave bujqësore; • Pilotimin e teknologjive të reja njëherë në Qendër dhe pastaj përhapjen e tyre në ferma, cka i jep atyre edhe rolin e "Fermës model". • Mbështetjen me informacion të politikëbërjes nga ana e MBUMK në fushën e bujqësisë, ushqimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit rural. MBUMK përcakton misionin dhe detyrat si dhe përgatit strukturën dhe organikën për qendra e sipërpërmendura.
MBUMK INSTITUTI I KËRKIMIT TË USHQIMIT (IKU), TIRANË	-Instituti integrohet së bashku me Institutin e Veterinarisë në Institutin e Sigurisë Ushqimore, Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit të Kafshëve pranë MBUMK (sot Instituti i Kërkimeve Veterinare, shih më poshtë).	Personeli i nevojshëm integrohet në institutin e ri mbi bazën e organikës së miratuar nga MBUMK.

INSTITUTI	PROPOZIMET KONKRETE PËR REFORMIMIN E INSTITUCIONIT KËRKIMOR	PROPOZIMET KONKRETE PËR INSTITUCIONIN E RI OSE ATË PRITËS
<u>MBUMK</u> 14. INSTITUTI KËRKIMEVE VETERINARE (IKV), TIRANË	-Bashkohet me Institutin e Kërkimit të Ushqimit për të formuar Institutin e Sigurisë Ushqimore, Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit të Kafshëve pranë MBUMK. Ky institut bëhet qendra kryesore e kompetencës në fushën e sigurisë ushqimore, kontrollit të cilësive së produkteve ushqimore për njërëzit dhe kafshët, kontrollit të barnave veterinarë, kontrollit të pesticideve, kontrollit të produkteve kozmetikës, përpunimin e programeve për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe mbikqyerjen e zbatimit të tyre, mbështetjen e MBUMK për prognostimin e situatave të krizave dhe menaxhimin e tyre . Bashkëpunon me kontratë me UBT në fushat e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve.	Në funksion të këtij riorientimi MBUMK dhe instituti duhet të ri-definojnë fushën e veprimtarisë së institutit dhe të rishikojnë strukturën dhe organikën e tij, në përputhje me modelin e institucioneve homologe të vendeve të tjera.
<u>MBUMK</u> 15. INSTITUTI KËRKIMEVE ZOOTEKNIKE (IKZ), TIRANË	-Instituti së bashku me Stacionin racor të gjedhit integrohet në Qendrën e Këshillimit dhe Transferimit të Teknologjisë të MBUMK në Fushë Krujë. -Godina dhe trualli i IKZ i kalojnë UBT. -Trualli i Stacionit Racor të Gjedhit, Tiranë mbetet për tu përdorur për qëllime publike. -Stacioni i Bagëtive të Imta, Korçë, bëhet pjesë e Qendrës e Këshillimit dhe Transferimit të Teknologjisë e MBUMK, në Korçë (shih më lart).	
<u>MBUMK</u> 16. INSTITUTI I MISRIT DHE ORIZIT, SHKODËR	-Kthehet në Qendër Këshillimi dhe Transferimi të Teknologjisë në Shkodër, në varësi të MBUMK. Lidh kontratë me UBT për praktikantë e studentëve.	

INSTITUTI	PROPOZIMET KONKRETE PËR REFORMIMIN E INSTITUCIONIT KËRKIMOR	PROPOZIMET KONKRETE PËR INSTITUCIONIN E RI OSE ATË PRITËS
MBUMK 17. INSTITUTI I PENTARISË, VLORE	--Kthehet në Qendër Këshillimi dhe Transferimi të Teknologjisë Vlorë, në varësi të MBUMK. Lidhë kontratë me UBT për praktikantë e studentëve. -Stacioni Eksperimental Valias, Tiranë, i kalon Dept. të Hortikulturës të UBT.	Personeli i Stacionit të Valiasit integrohet përmes konkursit në Dept. Hortikulturës të UBT, mbi bazën e organikës së miratuar nga UBT dhe MASH.
MBUMK 18. INSTITUTI MBROJTJES SË BIMËVE (IMB), SHKOZET	-Mbi bazën e këtij instituti dhe të një seksioni ekzistues në Departamentin e Hortikulturës dhe Mbrojtjes së Bimëve të Fakultetit të Bujqësisë të UBT krijohet Departamenti i Shëndetit të Bimëve në Fakultetin e Bujqësisë të UBT. Ky departament të marrë përsipër edhe shërbimet që ofron IMB. -Godinat, trualli dhe toka bujqësore të kalojnë në dispozicion të UBT.	Ky departament do të promovojë kërkimin shkencor në fushën e shëndetit të bimëve si dhe formimin e studentëve dhe shkencëtarëve të rinj në këtë fushë përmes moduleve në studimet Bachelor, kurseve të plota të Masterit si dhe doktoratave. Personeli i IMB integrohet në Dept. Shëndetit të Bimëve të UBT, mbi bazën e organikës së miratuar nga UBT dhe MASH.
MBUMK 19. INSTITUTI PERIME-PATATEVE, TIRANË	-Instituti shkrihet. -Detyrat e këshillimit dhe transferimit të teknologjisë në fushën e perime-patateve bëhen pjesë e detyrave të Qendrës së Këshillimit dhe Transferimit të Teknologjisë në Lushnje . -Godina dhe trualli në dispozicion të Këshillit të Ministrave. -Stacioni eksperimental dhe toka bujqësore në Selitë, Tiranë, të përdoren për qëllime publike.	-Departamenti i Prodhimit Bimor, UBT, merr përsipër funksionet e kërkimit shkencor në fushën e perime-patateve.

INSTITUTI	PROPOZIMET KONKRETE PËR REFORMIMIN E INSTITUCIONIT KËRKIMOR	PROPOZIMET KONKRETE PËR INSTITUCIONIN E RIOSE ATË PRITËS
MBUMK 20. INSTITUTI STUDIMIT TË TOKAVE, TIRANË (IST)	-Instituti shkrihet. -Për qëllime të këshillimit si dhe të monitorimit rutinë në fushën e mbrojtjes së tokës dhe ujitjen, MBUMK mund të krijojë një Sekcion për Mbrojtjen e Tokës dhe Ujitjen në përbërjen e Qendrës së Këshillimit dhe Transferimit të Teknologjisë e MBUMK , në Fushë Krujë. -Për promovimin e kërkimit në një fushë kaq të rëndësishme si shkencat e tokës krijohet Departamenti i Shkencave të Tokës në Fakultetin e Bujqësisë të UBT.	Departamenti i Agromjedisit i UBT rristrukturohet për të formuar Dept. Shkencave të Tokës . Ky departament do të promovojë kërkimin shkencor në shkencat e tokës si dhe formimin e studentëve dhe shkencëtarëve të rinj në këto shkenca përmes moduleve në studimet Bachelor, kurseve të plota të Masterit si dhe doktoratave.
MBUMK 21. ENTI I FARAVE DHE BANKA GJENETIKE, TIRANË	-Departamenti i Entit të Farave mbetet pranë MBUMK. -Departamenti i Bankës Gjenetike përfshihet në Dept. e Prodhimit bimor të UBT.	Departamenti i Prodh. Bimor i UBT rristrukturohet në Grupe Kërkimore-mësimore për të mundësuar integrimin edhe të këtij sektori. Hartohet organika e re që miratohet nga UBT dhe MASH dhe mbi bazën e saj integrohet me konkurs personeli i bankës gjenetike.
MIN. TURIZMIT, KULT., RINISË & SPORTEVE (MTKRS) 22. INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS, TIRANË	Instituti të mbetet në varësi të MTKRS dhe të reformohet për të mbështetur më mirë turizmin kulturor.	
MTKRS 3. QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE E SPORTIT, TIRANË	Të kalojë tek Akademia e Sporteve për të nxitur zhvillimin e kërkimit shkencor pranë Akademisë.	Akademia e Sporteve t'i krijojë mundësi integrimi Qendrës në procesin mësimor.

VENDIM
Nr.440, datë 28.6.2006

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z.Arben Ivanaj emërohet zëvendësministër i Shëndetësisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.449, datë 6.7.2006

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PËRFAQËSUESIT TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NË GRUPIN MBIKËQYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Nexhat Veipi, anëtar, përfaqësues i Këshillit të Ministrave, në grupin mbikëqyrës të kontrollit financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z.Bajram Malaj emërohet anëtar, përfaqësues i Këshillit të Ministrave, në grupin mbikëqyrës të kontrollit financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.458, DATË 8.7.2006

PËR “SHPALLJE DITË ZIJE KOMBËTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, si dhe të pikës 8 kreu VI të vendimit nr.229, datë 23.4.2004 “Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, për të nderuar kujtimin e burrit të shquar të kombit, humanistit Pjetër Arbnorit, legjendës së qëndresës së njeriut për liri dhe dinjitet njerëzor, simbolit të sakrificës dhe triumfit të vlerave të lirisë, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zije kombëtare, ditën e dielë, datë 9.7.2006, në nderim të humanistit, të ndjerit Pjetër Arbnori.
2. Në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike të ulet flamuri kombëtar në gjysmë shtize. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.460, datë 10.7.2006

PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE TË PËRDORË
PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”, PËR SHËRBIM KONSULENCE,
PËR PËRGATITJEN E TERMAVE TË PROKURIMIT/KONKURRIMIT
NDËRKOMBËTAR, VLERËSIMIN, PËRZGJEDHJEN DHE NEGOCIMIN E KONTRATËS
PËR NDËRTIMIN E SEKSIONIT QENDROR TË AUTOSTRADËS DURRËS-KUKËS-
MORINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, që, për fondin e vet limit prej 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) USD, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me konsorciumin Ecorys Group, për shërbim konsulence, për përgatitjen e termave të prokurimit/konkurrimit, ndërkombëtar, vlerësimin, përzgjedhjen dhe negociimin e kontratës për ndërtimin e seksionit qendror të autostradës Durrës-Kukës-Morinë, sipas termave të referencës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

TERMAT E REFERENCËS

Hyrje

Shqipëria ka një popullsi prej afro 3.5 milionë dhe një GNI prej 4,4 miliardë dollarë amerikanë. Sektori i transportit në Shqipëri ka ndryshuar në mënyrë radikale që nga viti 1991, duke reflektuar ndryshimet strukturore në ekonomi dhe rindërtimin e tregut të lirë në rajon. Përpara 1990-ës pronësia private në infrastrukturën e transportit ose mbi mjetet e transportit ishte e ndaluar. Kjo rezultoi në një infrastrukturë të projektuar dhe të ndërtuar për t'i shërbyer vetëm mjeteve shtetërore të transportit. Rrjeti rrugor shqiptar ka afërsisht 18 300 km rrugë, nga të cilat 3 221 km janë rrugë nacionale, 4 139 km janë rrugë rajonale, 10 000 km rrugë lokale dhe 1000 km janë rrugë urbane. Nga këto, më pak se 3000 km janë të asfaltuara. Sasia e automjeteve është rritur nga pothuajse 0 në 233.000 njësi në vitin 2002. Pothuajse 70% e të gjitha automjeteve janë të regjistruara në zonën e Tiranës. Trafiku i tanishëm kërkon standarde, për të cilat infrastruktura ekzistuese nuk mund të shërbejë kurrësi.

Rrugët dhe urat janë shpesh shumë të ngushta, të dëmtuara, me mungesa në sinjalistikën e nevojshme dhe me nivel të lartë pasigurie.

Infrastruktura rrugore është kritike për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, veçanërisht kur vendi është pranë hyrjes në Komunitetin Europian. Nëpërmjet transportit rrugor kryhet 89% e transportit të mallrave dhe që tani arrin në 1 miliard ton mallra.

Përmirësimi i rrjetit rrugor kombëtar është fokusuar në akset rrugore Veri-Jug dhe Lindje-Perëndim, projektuar dhe ndërtuar me ndihmën e disa institucioneve ndërkombëtare financiare. Aksi rrugor Veri-Jug lidh Hanin e Hotit (Kufi me Malin e Zi) dhe Kakavijën (kufi me Greqinë) duke kaluar nga ultësira perëndimore dhe nga Porti i Durrësit. Aksi rrugor Lindje-Perëndim lidh Portin e Durrësit me Qafë-Thanën (kufi me Maqedoninë) dhe Kapshticën (kufi me Greqinë).

Korridorin e VIII Trans-Europian, që është parashikuar të lidhë portet italiane të Barit dhe Brindisit me portet në Detin e Zi të Burgas dhe të Varnas në Bullgari nëpërmjet porteve të Durrësit dhe të Vlorës (Shqipëri) duke kaluar në Shkup (Maqedoni), është identifikuar si një nga prioritetet e korridoreve europiane.

Korridorin Durrës-Kukës-Morinë është aksi rrugor Verilindje-Jugperëndim që lidh Kosovën dhe korridorin X në Nish me Portin e Durrësit dhe është prioriteti numër 1 i qeverisë aktuale. Banka Botërore është duke përgatitur një kredi prej 25 milionë USD për ndërtimin e një rruge të re dhe përmirësimin e seksionit të parë prej 26 km të këtij korridori, ndërmjet Milotit dhe Rrëshenit. Seksioni i tretë prej 27 km ndërmjet Kalimashit dhe Morinës, në kufi me Kosovën, po ndërtohet me fondet e Qeverisë Shqiptare. Seksioni qendror prej 48 km, përmes një terreni të ashpër malor, do të ndërtohet gjithashtu duke përdorur fondet publike përmes një prokurimi kompetitiv për përzgjedhjen e një kompanie ndërtimi të madhe ndërkombëtare.

Kufizimet në kapacitete të njësive publike përgjegjëse për sektorin e infrastrukturës nxisin angazhimin e Qeverisë në përzgjedhjen e një grupi ekspertësh të pavarur teknikë, financiarë dhe ligjore për ta mbështetur atë gjatë këtij procesi. Detyra e këtij grupi konsultimesh përfshin dhënien e asistencës teknike, ligjore dhe financiare për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT)/Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve (DPRR) për vlerësimin, përzgjedhjen, negocimin dhe nënshkrimin e një kontrate të tillë.

Objektivat e detyrës

Objekti i përgjithshëm i kësaj detyre është t'i sigurojë MPPTT/DPRR konsulencë të plotë në përgatitjen e termave të prokurimit/konkurritit ndërkombëtar, vlerësimin, përzgjedhjen dhe negocimin e kontratës.

Objektivat e tjera përfshijnë sa më poshtë vijon:

- Të identifikohen burime të tjera potenciale të financimit (të tilla si grante nga Bashkimi Europian, hua/kredi shumëpalëshe dhe bilaterale) për të plotësuar investimin e pritur privat dhe të

rekomandohen opsione për qeverinë për të kontrolluar këto burime shtesë për investimet prioritare të kërkuara.

- Të udhëzojë MPPTT/DPRR se si të konvertojnë një propozim të dhënë në një proces të hapur dhe kompetitiv (p.sh. llojet e ankandeve zvicerane) dhe

- Të rekomandojë procedurat e prokurimit dhe të identifikojë dhe ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme deri në nënshkrimin e kontratës për këtë seksion prioritar të korridorit.

Qëllimi i detyrës

Roli kryesor i konsulentëve të caktuar është të ruajnë një prezencë konstante pranë MPPTT/DPRR gjatë kohëzgjatjes së detyrës për të këshilluar në prokurimin/konkurrimin e kontraktorit ndërkombëtar për të zbatuar punimet në periudhën kohore të përcaktuar.

Detyra 1: Marrëdhëniet institucionale dhe vlerësimi i mundësisë së pjesëmarrjes private

- Përcaktimi së bashku me përfaqësuesit e MPPTT/DPRR i natyrës së transaksionit:

- Vlerësimi i tregut për tenderues potencialë për të parë nëse ka gjasa të ketë interes në një propozim të tillë dhe sipas çfarë termash.

- Identifikimi i marrëdhënieve preferenciale institucionale (si p.sh. lloje të ndryshme të ankandeve zvicerane) për prezantimin e konkurrimit në procesin e prokurimit për një propozim të dhënë.

- Identifikimi dhe diskutimi me kontraktorët potencialë i perceptimit të metodave të tilla.

- Identifikimi i mundësisë së kontraktorëve potencialë për të menaxhuar një financim koncesionar me transhe.

- Rekomandimi i procedurave të përshtatshme për prokurimin e kontraktorit, metodave të ndryshme të tenderimit dhe vlerësimi i propozimeve për të siguruar transparencën gjatë procesit dhe vlerën më të mirë.

Detyra 2: Përgatitja e dokumentacionit të prokurimit/konkurrimit ndërkombëtar

Në bashkëpunim me MPPTT/DPRR, të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shpalljen dhe realizimin e procedurës së prokurimit/konkurrimit ndërkombëtar.

Detyra 3: Vlerësimi i rezultateve të prokurimit/konkurrimit ndërkombëtar

Të asistojë MPPTT/DPRR në vlerësimin e ofertave dhe rezultateve të prokurimit/konkurrimit dhe përzgjedhjen e kontraktorit.

Detyra 4: Negocimi i kontratës

Të asistojë MPPTT/DPRR në negociimin, hartimin dhe lidhjen e kontratës.

Përbërja e ekipit të konsulentit

Studimi do të drejtohet nga një ekspert finance, privat, i familjarizuar me sektorin e transportit në Europën Juglindore, i cili do të shërbejë si menaxher projekti. Menaxheri i projektit pritet të mbështetet nga një ekip i përbërë nga një inxhinier autostradash, specialist ekonomist/financier për transportin dhe specialist ligjor në prokurimet dhe projektet e mëdha të infrastrukturës.

Menaxhimi i detyrës

Menaxhimi i detyrës do të jetë në përgjegjësinë e MPPTT/DPRR.

Plani kohor dhe raportimet

Detyra do të zgjasë rreth 2 muaj. Data e fillimit të konsulencës pritet të jetë java e dytë e korrikut 2006.

Kontrata do të jetë e bazuar mbi kohën dhe konsulentët duhet të specifikojnë të gjitha çmimet njësi dhe dietat për stafin kryesor.

VENDIM
Nr.462, datë 5.7.2006

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE, ZNJ.LINDITA ÇALA, PËR STREHIMIN E FAMILJES SË SAJ, NËPËRMJET ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të pikave 1 e 2 të nenit 4 të ligjit nr.9416, datë 20.5.2005 “Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fondet shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave” dhe të ligjit nr.9464, 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien zonjës Lindita Çala të ndihmës financiare, në shumën 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, për lindjen e katërnjakëve dhe për strehimin e familjes së saj, në një banesë, të blerë në tregun e lirë, në qytetin e Tiranës, sipas procedurave të Entit Kombëtar të Banesave.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të vërë në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave shumën prej 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekësh, nga fondet për strehim, e cila të shlyhet nga përfituesja, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9416, datë 20.5.2005 “Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fondet shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”.

4. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.475, datë 12.7.2006

PËR DHËNIEN E EMRIT “ARBNO RI” QENDRËS NDËRKOMBËTARE TË KULTURËS

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës në Tiranë, t’i jepet emri “Arbnori”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.476, datë 12.7.2006

PËR MBULIMIN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA, PËR SHPENZIMET E TRANSPORTIT TË MËSUESVE DHE TË NXËNËSVE, TË TRASHËGUARA NGA VITI 2003

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të mbulojë detyrimet e prapambetura, për transportin e mësuesve dhe të nxënësve, të trashëguara nga viti 2003, përkatësisht, për zyrën arsimore, Kavajë, në shumën 2 000 000 (dy milionë) lekë, dhe për drejtorinë arsimore rajonale të qarkut të Tiranës, në shumën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.

2. Fondi prej 2 700 000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekësh të përballohet nga fondet buxhetore të vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.481, datë 14.6.2006

PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE TË PËRDORË PROCEDURËN E PROKURIMIT “TENDER I HAPUR NDËRKOMBËTAR, PËR NDËRTIMIN, ME RITME TË PËRSHPEJTUARA”, TË SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH, TË AUTOSTRADËS Durrës-KUKËS-MORINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, që të përdorë procedurën e prokurimit “Tender i hapur ndërkombëtar, për ndërtimin me ritme të përshpejtuara” të segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash, të autostradës Durrës-Kukës-Morinë, si më poshtë vijon:

a) Publikimin e kërkesës për shprehje interesi, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet njoftimit në “Gazetën Zyrtare” të Komisionit European dhe gazetën “Financial Times”.

b) Kandidatët e interesuar të dorëzojnë shprehjen e interesit, jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i kërkesës për shprehje interesi.

c) Kandidatët e interesuar të klasifikohen sipas nivelit të kualifikimit për karakteristikat e projektit. Ky klasifikim të bëhet nga një komision ndërkombëtar vlerësimi, i pavarur, i përbërë nga pesë anëtarë, të caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të propozimeve të konsulentit ndërkombëtar “Ecorys Group”, që asiston në përgatitjen e procedurave të prokurimit.

ç) Klasifikimi të bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:

i) Situata financiare; xhiro vjetore në punime civile prej të paktën një miliard dollarësh amerikanë dhe shoqëria, si e tërë, të ketë rezultuar me fitim për tre vitet e fundit (kriter kalues/skualifikues);

ii) Përvoja në rajon (masë vlerësimi 10 për qind);

iii) Përvoja me tunelet (masë vlerësimi 10 për qind);

iv) Përvoja në menaxhimin e procesit të hartimit të projektit teknik dhe vlerës inxhinierike (masë vlerësimi 15 për qind);

v) Përvoja në sigurimin e financimit, garancive dhe kredive të eksportit (masë vlerësimi 15 për qind);

vi) Përvoja e drejtuesit të punimeve (masë vlerësimi 10 për qind);

vii) Përvoja me kontrata me çmime njësi (masë vlerësimi 5 për qind);

viii) Përvoja në realizim projektesh, në kohë dhe brenda buxhetit (masë vlerësimi 20 për qind);

ix) Propozimi për të siguruar çmim të arsyeshëm dhe realizimin në kohë (masë vlerësimi 15 për qind).

d) Komisioni i vlerësimit t'i klasifikojë ofertuesit me një notë nga 1 deri në 10, për çdo kriter, ku një notë mund të përdoret vetëm një herë për secilin kriter të përcaktuar, shumëzuar kjo me përqindjen e masës së vlerësimit dhe mbledhur për nëntë kriteret.

dh) Kandidati i klasifikuar me më shumë pikë të ftohet për negociatë, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje të ndërsjellë për metodologjinë e çmimit dhe planin e punimeve. Çmimet për njësi mund të jenë objekt i verifikimit të pavarur prej një pale të tretë, në varësi të negociatave.

e) Pas përfundimit me sukses të negociatave me kandidatin e klasifikuar me më shumë pikë, të bëhet njoftimi për procedim.

ë) Në rast të negociatave të pasuksesshme me kandidatin e klasifikuar i pari, me më shumë pikë, të ftohet për negociim kandidati i klasifikuar i dyti.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.491, datë 31.5.2006

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 "Për statistikën zyrtare", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Besa Peçi, anëtare e Këshillit të Statistikave, lirohet nga ky funksion.

2. Znj. Shqiponja Lamçe emërohet anëtare e Këshillit të Statistikave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.499, datë 19.7.2006

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË
DIVJAKË TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Divjakë të qarkut të Fierit.

Lista me 108 (njëqind e tetë) fletë përfundon me numrin rendor 723 (shtatëqind e njëzet e tre).

2. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Divjakës, sipas tabelës në lidhjen nr.1 dhe që i referohet pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme dhe bashkia e Divjakës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.521, datë 26.7.2006

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Florent Çeliku, zëvendësministër i Punëve të Jashtme, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Anton Gurakuqi emërohet zëvendësministër i Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.522, datë 26.7.2006

**PËR TRANSFERIMIN E SIPËRFAQES 91 M², KOMPONENTE E PRONËS NR.1095
“DEGA E MOBILIZIM-REKRUTIMIT”, KUÇOVË, NGA MINISTRIA E MBROJTJES NË
PRONËSI TË BASHKISË SË QYTETIT KUÇOVË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të sipërfaqes 91 m², komponente e pronës me numër rendor 1095 “Dega e mobilizim-rekrutimit”, Kuçovë, nga Ministria e Mbrojtjes, në pronësi të bashkisë së Kuçovës, në kuadër të zbatimit të projektit CARDS, të financuar nga Banka Botërore, për rikonstrukcionin e rrugës “Naftëtari 3.1.1”.

2. Nga prona nr.1095 “Dega e mobilizim-rekrutimit”, Kuçovë, të hiqet sipërfaqja 91 m² nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Bashkisë së qytetit Kuçovë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, kryetari i bashkisë së Kuçovës dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.527, datë 2.8.2006

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË TRE ANËTARËVE TË ENTIT RREGULLATOR TË
UJIT (ERRU)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin anëtarë të Entit Rregullator të Ujit, për një mandat 4-vjeçar, të tre kandidaturave të përzgjedhura nga Komisioni Kombëtar i Ujit, si më poshtë vijon:

- Znj.Aida Gojani, ekonomiste;
- Znj.Luljeta Hoxha, inxhinieri hidroteknike;
- Z.Arjan Jovani, inxhinier hidroteknik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PËR PAJISJEN ME MJEDISE TË PARTISË DEMOKRISTIANE

VENDOSI:

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr.534, datë 4.8.2006

PËR PAJISJEN ME MJEDISE TË PARTISË REPUBLIKANE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 22 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim Partisë Republikane të mjediseve të katit të dytë, të ish-hotel “Drini”-t, në shtesën e re 5-katëshe, me sipërfaqe 323 m², në Rr. “Abdi Topani”, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si mjedise për seli.

2. Mjediset, që aktualisht janë në përdorim të Partisë Republikane, t’i kalojnë në përdorim Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.535, datë 4.8.2006

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, TË INSTITUTIT TË STUDIMIT TË TOKAVE
DHE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediseve të ndërtesës së Institutit të Studimit të Tokave, që janë në përdorim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit te Ministria e Financave, për t’u përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Mjediseve të lira të Institutit të Studimit të Tokave, kati përdhe dhe i dytë, që janë në administrim të këtij të fundit, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit, nga Instituti i Studimit të Tokave te Ministria e Financave, për t’u përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Mjediseve të godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, katet përdhe, i dytë, i tretë dhe i katërt, që janë në administrim të kësaj të fundit, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave te Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për t’u përdorur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit u ndalohej ta ndryshojnë destinacionin e pronave të përcaktuara në këtë vendim, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për të përballuar shpenzimet e transferimit, të përdorë fondet e dhëna në buxhetin shtesë, për vitin 2006.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Instituti i Studimit të Tokave dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.536, datë 4.8.2006

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE TË ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT I KALOJNË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE, DEGA E TATIM-TAKSAVE, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të kateve, të pestë dhe të gjashtë, me sipërfaqe të përgjithshme 2 400 m², të ndërtesës së Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dega e tatim-taksave, Tiranë.

2. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.540, datë 10.8.2006

PËR ORGANIZIMIN E CEREMONISË, NË NDERIM TË VIKTIMAVE TË AKSIDENTIT AJROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006” dhe të vendimit nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Ceremoniali zyrtar i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizimin e ceremonisë jo të plotë zyrtare, në nderim të viktimave të aksidentit të datës 16.7.2006, gjatë kryerjes së fluturimit ajror, për përmbushjen me sukses të misionit humanitar.

2. Homazhet bëhen ditën e premte, datë 11.8.2006 dhe përfshijnë kryerjen e vizitave nga ora 10.00-12.00, në hollin e Pallatit të Kongreseve, dhe në orën 13.00 hedhjen e buqetave me lule në det të hapur nga bordi i një anijeje.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar për vitin 2006.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për organizimin e ceremonialit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.553, datë 16.8.2006

**PËR NJEHSIMIN E FUNKSIONEVE ORGANIKE SIPAS GRADAVE NË STRUKTURËN E
GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr.8869, datë 21.3.2002 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 11 e 26, pika 1, të ligjit nr.9366, datë 31.3.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njehsimi i funksioneve organike, sipas gradave, në strukturën e Gardës së Republikës së Shqipërisë të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në asnjë rast punonjësit, brenda çdo strukture (komandë, shtab, degë, njësi apo sektor), nuk duhet të kenë gradë më të lartë se eprori, edhe kur funksionet organike janë të të njëjtit nivel.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.569, datë 23.8.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.267, DATË 10.5.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E EKSPERTËVE FINANCIARË NË SHOQËRITË
HUAMARRËSE, NË ADMINISTRIM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8279, datë 23.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën emërore të ekspertëve financiarë të shoqërive huamarrëse, që i bashkëlidhet vendimit nr.267, datë 10.5.2006 të Këshillit të Ministrave, z.Dashnor Kozaj, ekspert financiar për kontrollin e shoqërive huamarrëse, zëvendësohet me z.Sabri Palamani, ekspert financiar për kontrollin e shoqërive huamarrëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.570, datë 23.8.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.335, DATË 20.6.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “b” e pikës 12 të vendimit nr.335, datë 20.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Në organin qendror apo vendor, i cili vë në dispozicion fondin, brenda 5 ditëve pas mbarimit të afatit të ankesës pranë entit prokurues. Organi, qendror apo vendor, është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 5 ditëve nga marrja e ankesës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.572, datë 24.8.2006

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË SË
KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të pikës 6 të vendimit nr.566, datë 23.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e zj. Justina Boriçi në detyrën e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

2. Marrëdhëniet, juridike dhe financiare, të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, fillojnë më datë 24.8.2006.

3. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.573, datë 23.8.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS HYSGJOKAJ TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore (lidhja nr.1), që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Hysgjokaj të qarkut të Fierit, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Hysgjokaj të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.130, datë 11.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Hysgjokaj”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Hysgjokaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Hysgjokaj

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i tansferimit
5;15-18	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore.	Në pronësi
20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
44,45,46,47,48,49,50,51, 52,53,54,55,56,57-78	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
90,91,92,93,94,95,96,97, 98	Infrastrukturë (troje, rrugë vendore)	Në pronësi
88	Shërbim funeral	Në pronësi
4	Mbrojtje civile	Në pronësi
120-123	Shërbim publik (furnizim me ujë)	Në pronësi
31,32,33,36,38	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproductive).	Në pronësi
28,30	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

VENDIM
Nr.584, datë 23.6.2006

**PËR NGRITJEN E MONUMENTIT TË HEROIT TË DEMOKRACISË, AZEM HAJDARI,
NË QYTETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, e 100 e Kushtetutës dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e monumentit të heroit të demokracisë dhe pluralizmit, Azem Hajdari, në krahun juglindor, të lulishtes “Parku Rinia”, në qytetin e Tiranës, sipas skemës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Parku Rinia





Foto satelitore

Fragment i studimit te qendres



VENDIM
Nr.585, datë 23.8.2006

**PËR HAPJEN E KONSULLATËS SË PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË NJU-JORK, SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Nju-Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.586, datë 23.8.2006

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT “PROGRAMI ILIRIA”,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE, PËR FUTJEN E GJUHËS ITALIANE NË
SISTEMIN PARAUNIVERSITAR SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit “Programi Iliria”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, për futjen e gjuhës italiane në sistemin parauniversitar shqiptar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI
PËR “PROGRAMIN ILIRIA” NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE PËR FUTJEN E
GJUHËS ITALIANE NË SISTEMIN PARAUNIVERSITAR SHQIPTAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane, këtu më poshtë të quajtura “Palë”,

duke marrë në konsideratë marrëveshjen e bashkëpunimit kulturor ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Italiane, nënshkruar në Tiranë më 12 shtator 1994;

duke marrë në konsideratë Protokollin e Komisionit të Përbashkët Shqiptaro-Italian për bashkëpunimin ekonomik, industrial dhe teknik, nënshkruar në Tiranë më 9 prill 2002;

duke konsideruar interesin e përbashkët për të mbështetur përhapjen e gjuhës italiane në shkollat shqiptare,

kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Pala shqiptare, duke respektuar kërkesat e qytetarëve të saj, merr përsipër futjen e mësimin të gjuhës italiane si gjuhë e parë e huaj në arsimin e detyrueshëm dhe në shkollat e mesme, me synim mësimin e kësaj gjuhe, brenda vitit 2010, nga të paktën 10% e numrit të nxënësve që mësojnë gjuhë të huaja, duke lejuar zgjedhjen e gjuhës italiane, si gjuhë e parë e huaj në të gjitha shkollat shqiptare, ku parashikohet studimi i një ose më tepër i gjuhëve të huaja.

Neni 2

Pala italiane do të mbështesë katedrat e gjuhës italiane, përmes dhënies së kontributeve ekonomike për dhënien e stimuljeve mësuesve shqiptarë të angazhuar, në kuadër të projektit, për mësimdhënien e gjuhës italiane dhe në aktivitetet e formimit dhe të programit për dy fazat para të përfshirjes së tyre në projekt. Stimuli nuk duhet të kalojë 30%-in e rrogës mujore vendase dhe do të jetë në përpjesëtim me numrin e orëve javore të kryera.

Neni 3

Pala italiane do të bashkëpunojë për kualifikimin profesional të mësuesve shqiptarë përmes hapave të saj, të koordinuara me palën shqiptare, ose do t’u ofrojë kontributin e saj hapave të ndërmarrë nga vetë autoritetet kompetente shqiptare.

Neni 4

Pala shqiptare, me konsulencën e palës italiane, do të përgatisë dhe miratojë programet dhe kurset e nevojshme të gjuhës italiane për klasat e arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm.

Neni 5

Pala italiane do të kontribuojë, gjatë kohëzgjatjes së projektit, për pajisjen me materiale didaktike për aktivitetet e shkollave, ku futet mësimdhënia e gjuhës italiane, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse shqiptare.

Neni 6

Pala shqiptare zotohet të marrë çdo masë të mundshme për plotësimin e kushteve logjistike funksionale, për futjen e gjuhës italiane në shkollat shqiptare, për të cilat bëhet fjalë në këtë memorandum.

Neni 7

Pala shqiptare zotohet, për të gjithë kohëzgjatjen e projektit, që të favorizojë qëndrimin në programet shkollore, për të cilat bëhet fjalë në këtë memorandum, të mësuesve shqiptarë të përfshirë në këtë projekt dhe që kanë marrë pjesë në aktivitetet e formimit.

Neni 8

Ky memorandum do të hyjë në fuqi në ditën e marrjes së njoftimit të fundit, me anën e të cilit palët i komunikojnë njëra-tjetrës, nëpërmjet kanaleve diplomatike, përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për këtë qëllim, dhe do të jetë në fuqi deri në fund të vitit 2010.

Duke bazuar në sa më sipër, përfaqësuesit e autorizuar siç duhet nga qeveritë përkatëse nënshkruan këtë memorandum mirëkuptimi.

Bërë në Tiranë, më 11.7.2006 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën italiane dhe shqipe duke qenë të dy tekstet të barasvlefshme.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Genc Pollo

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS ITALIANE
AMBASADORI I ITALISË
Attilio Massimo Iannucci

VENDIM

Nr.588, datë 30.8.2006

PËR DËRGIMIN NË PARIS, FRANCË, TË 5 IKONAVE, OBJEKTE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, TË LUAJTSHME, ME VLERA TË VEÇANTA, PËR EKSPOZIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin, në Paris, Francë, të 5 ikonave, objekte të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta, së bashku me dokumentacionin përkatës identifikues, për t’u ekspozuar, në selinë e UNESCO-s, në veprimtarinë “Ditë të trashëgimisë kulturore shqiptare në Paris”.

2. Koha e qëndrimit të këtyre objekteve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të jetë nga data 30 gusht 2006 deri më 16 shtator 2006.

3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM
Nr.592, datë 31.8.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.56, DATË 28.1.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E MARZHEVE TË FABRIKIMIT DHE TË
TREGTIMIT TË BARNAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 50 të ligjit nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.56, datë 28.1.2005 të Këshillit të Ministrave, pas fjalisë së parë të pikës 2, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Nga kjo bëjnë përjashtim barnat kontraceptivë, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat kufiri maksimal i çmimit të shitjes me shumicë, përfshin një marzh mbi çmimin CIF, në masën e përcaktuar në këtë shtojcë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCË 1: LISTA E BARNAVE KONTRACEPTIVË DHE MARZHI I TREGTIMIT ME
SHUMICË

Emër bari	Forma	Emri tregtar	Marzhi i tregtimit me shumicë
1. Levonorgestrel 0.75 mg	tabelë	Postinor 2	deri në 44%
2. Medroxyprogesterone Acetate 150 mg	Sol.injektabël	Depoprovera	deri në 40%

VENDIM
Nr.599, datë 31.8.2006

PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË KUALIFIKIMIT SHKENCOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni i Kualifikimit Shkencor të përbëhet nga 15 anëtarë, si më poshtë vijon:
a) Në detyrë funksionale shtetërore:

- | | |
|---|----------------|
| 1. Ministri i Arsimit dhe Shkencës | Kryetar |
| 2. Përfaqësues nga Akademia e Shkencave | 1 (një) anëtar |
| 3. Përfaqësues nga Konferenca e Rektorëve | 1 (një) anëtar |

b) Me titull personal:

1. Prof.dr. Artan Fuga
2. Prof.dr. Valentina Duka
3. Prof.dr. Antoneta Deda
4. Prof.dr. Margarita Qirko
5. Prof.dr. Marenglen Gjonaj
6. Prof.dr. Niko Pojani
7. Prof.dr. Myqerem Tafaj
8. Prof.dr. Fatos Harizaj
9. Prof.dr. Mentor Petrela
10. Prof.dr. Ndok Marku
11. Prof.dr. Omer Stringa
12. Prof.dr. Sokol Shupo.

2. Vendimi nr.191, datë 20.3.1998, i Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Komisionit të Kualifikimit Shkencor”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.6.2010

Doli nga shtypi më 6.6.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë